Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë

anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$$MO = O1 + O2 + O3 + \dots + On / N$$

$$PR = 85 \% Mo$$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet

para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për

Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;

b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

like ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objektështë i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

A) Fikëse zjarri me pluhur të thatë ABC 40%

Fikësit me pluhur të thatë e pengojnë në mënyrë kimike ndezjen dhe mund të quhen ngadalësues universal të zjarreve. Pluhuri i thatë jo vetëm që është efektiv kundër zjarreve të grupit A dhe B, por është i dobishëm për të luftuar edhe zjarret e grupit C.

Fikëset e zjarrit me pudër ABC 40%: 6kg, 9 kg, 12 kg, 25 kg, 30 kg dhe 50 kg përdoren për të fikur dhe parandaluar zjarrin i cili mund të jetë shkaktuar nga djegia e:

A-letrave, tekstileve, drurit dhe plastikës.

B- lëndëve djegëse

C- zjarrin e shkaktuar nga pajisje elektrike.

Fikja realizohet duke hedhur pudrën rrotull vatrës së zjarrit me qëllim parandalimin dhe eliminimin e zjarrit. Bombola është e ndërtuar nga çelik special sipas standarteve europiane.

FIKËSE ZJARRI ME PLUHUR ABC 40%, 6 kg	
Klasa e zjarrit	A,B,C
Temperatura e punës	-30°C +60°C
Kohëzgjatja e funksionit të vazhdueshëm	≈ 10 sec
Rrezja e lëshimit	≈ 5 m
Lartësia	≈ 550 mm
Diametri	≈ 160 mm
Ngarkesa nominale	≈ 6 kg
Pesha e bombolës pas rimbushjes	≈ 9 kg

FIKËSE ZJARRI ME PUDËR ABC 40%, 9 kg	
Klasa e zjarrit	A,B,C
Temperatura e punës	-30°C +60°C
Kohëzgjatja e funksionit të vazhdueshëm	≈ 17 sec
Rrezja e lëshimit	≈ 7 m
Lartësia	≈ 600 mm
Diametri	≈ 180 mm
Ngarkesa nominale	≈ 9 kg
Pesha e bombolës pas rimbushjes	≈ 13 kg

FIKËSE ZJARRI ME PUDËR ABC 40%, 12 kg	
Klasa e zjarrit	A,B,C
Temperatura e punës	-30°C +60°C
Kohëzgjatja e funksionit të vazhdueshëm	≈ 18 sec
Rrezja e lëshimit	≈ 7 m
Lartësia	≈ 660 mm
Diametri	≈ 190 mm
Ngarkesa nominale	≈ 12 kg
Pesha e bombolës pas rimbushjes	≈ 17.5 kg

FIKËSE ZJARRI ME PUDËR ABC 40%, 25 kg	
Klasa e zjarrit	A,B,C
Temperatura e punës	-30°C +60°C
Kohëzgjatja e funksionit të vazhdueshëm	≈ 25 sec
Rrezja e lëshimit	≈ 11 m
Lartësia	≈ 1080 mm
Diametri	≈ 190 mm
Ngarkesa nominale	≈ 25 kg
Pesha e bomboles pas rimbushjes	≈ 55 kg

FIKËSE ZJARRI ME PUDËR ABC 40%, 30 kg	
Klasa e zjarrit	A,B,C
Temperatura e punës	-30°C +60°C
Kohëzgjatja e funksionit të vazhdueshëm	≈ 30 sec
Rrezja e lëshimit	≈ 11 m

Lartësia	≈ 1080 mm
Diametri	≈ 190 mm
Ngarkesa nominale	≈ 30 kg
Pesha e bomboles pas rimbushjes	≈ 61 kg

FIKËSE ZJARRI ME PUDËR ABC 40%, 50 kg

Klasa e zjarrit	A,B,C
Temperatura e punës	-30°C +60°C
Kohëzgjatja e funksionit të vazhdueshëm	≈ 49 sec
Rrezja e lëshimit	≈ 12 m
Lartësia	≈ 1050 mm
Diametri	≈ 300 mm
Ngarkesa nominale	≈ 50 kg
Pesha e bomboles pas rimbushjes	≈ 84 kg

KARAKTERISTIKAT E PLUHURIT

Subjekti	Karakteristikat	Specifikimet
Përbërja Kimike (%)	Fosfat monoamoniumi 40 Sulfat amoniumi 51	38 – 42 49 – 53
Dëndësia (g/ml)	(g/ml) 0.89	0.82 – 0.96
Analiza e granulimit	Sita 125µm 19 Sita 63µm 45 Sita 40 µm 60	14 - 24 37 – 53 52 – 68
Rezistenca ndaj ngurtësimit	Sita 425µm 0	0
Rezistenca nga uji	Përthithje e ujit Nuk ka	Nuk ka
Përqindja e lagështisë	(%) <0.25	<0.25

B) Fikëse zjarri me shkumë AFFF 916

Fikëse zjarri me shkumë dhe përdoret për parandalimin dhe fikjen e zjarrit në prezencën e vajrave dhe yndyrnave.

Përshkrimi

AFFF C6 916 është një koncentrat sintetik me cilësi të lartë sintetike (AFFF) për shuarjen dhe sigurimin e zjarreve nga hidrokarbure të ndezshme.

C6 916 është një kombinim i veçantë i agentëve aktivë hidrokarbure dhe fluorohemik. Materiali përhapet me shpejtësi mbi sipërfaqen dhe hapësirën ku ka zjarr duke siguruar kontroll të shpejtë dhe shuarje të menjëhershme. Krijon formim të shpejtë të shtresës për ndërprerje të shpejtë të flakës dhe shuarje të menjëhershme.

Aplikimet

AFFF C6 916 përdoret në situata me rrezikshmëri të lartë zjarri ku ka përdorim të vajrave, gazit, panele energjie dhe platforma të tjera. Shkuma AFFF C6 916 siguron një shtresë (në formë batanije) të shkumëzuar në vatrën e zjarrit, që paralizon dhe ndërpret në mënyrë të menjëhershme shpërndarjen e vatrës së zjarrit.

Vetitë fiziko-kimike të shkumës

Fikse zjarri shkumë 6 litra

- Kapaciteti: 6 litra
- Përdorimi: AFFF 3-6% shkumë
- Temperatura e punës: 0°C deri në 49°C

Temperatura maksimale e ruajtjes së vazhdueshme deri në 49°C

Temperatura maksimale e magazinimit me ndërprerje deri në 60°C

Pika e ngrirjes; -1°C

Efekti i ngrirjes/shkrirjes; Produkti nuk dëmtohet nga ngrirja.

Shkuma që përdoret për mbrojtjen dhe fikjen e zjarrit në prezencën e hidrokarbureve duhet të plotësojë standartet e mbrojtjes sipas ligjeve në fuqi.

FIKËSE ZJARRI ME SHKUME AFFF 916	
Klasa e zjarrit	A,B
Temperatura e punës	-30°C +60°C
Kohëzgjatja e funksionit të vazhdueshëm	≈ 42 sec
Rrezja e lëshimit	≈ 12 m
Lartësia	≈ 550 mm
Diametri	≈ 160 mm
Pesha e bombolës pas rimbushjes	≈ 10 kg
Ngarkesa nominale	6 Litra

C) Fikëse zjarri me CO2

Fikëset e zjarrit me dioksid karboni përdoren vetëm për fikjen e klasave B dhe C të zjarrit, zjarri i lëngshëm (vajrat, yndyrnat) dhe elektrik (aparaturat elektrike).

Fikësit e zjarrit me CO2 fikin zjarret duke zëvendësuar oksigjenin, pa të cilin nuk mund të ketë zjarr, me gazin inert CO2. Gjithashtu dioksidi i karbonit është shumë i ftohtë pasi del nga fikësi, kështu që ftoh edhe karburantin.

Fikja realizohet duke hedhur dioksidin e karbonit rrotull vates së zjarrit me qëllim parandalimin dhe eliminimin e zjarrit, gjithashtu dioksidi i karbonit ndihmon në uljen e temperaturës. Bombula është e ndërtuar nga çelik special sipas standarteve europiane.

FIKSE ZJARRI CO2, 2 kg	
Klasa i zjarrit	≥ 34 B
Temperatura e punës	-20°C +60°C
Kohëzgjatja e funksionit të vazhdueshëm	≈ 7 sec
Rrezja e lëshimit	≥ 2 m
Lartësia	≈ 550 mm
Diametri	≈ 120 mm
Ngarkesa nominale	2 kg
Pesha e bombolës pas rimbushjes	≈ 5 kg

FIKSE ZJARRI CO2, 5 kg	
Klasa i zjarrit	≥ 89 B
Temperatura e punës	-20°C +60°C
Kohëzgjatja e funksionit të vazhdueshëm	≈ 10 sec
Rrezja e lëshimit	≥ 3 m
Lartësia	≈ 700 mm
Diametri	≈ 130 mm
Ngarkesa nominale	≈ 5 kg
Pesha e bombolës pas rimbushjes	≈ 12 kg

Shënim: Pas përfundimit të shërbimit, për çdo pajisje duhet të vendoset një etiketë ngjitëse ku të përcaktohet **koha e shërbimit dhe afati i garancisë.** Fikësja e zjarrit (nëse nuk ka) të pajiset me një shenjë dalluese fosforeshente në trup, kjo për efekt dallimi lehtësisht në errësi.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen:

Nr.	Përshkrimi i mallrave	Njësia	Sasia per vitin 2025	Sasia per vitin 2026	Sasia Totale 2025-2026
1	Rimbushje dhe Kolaudim pajisje fikëse zjarri 6 kg me pluhur ABC mbi 40%	copë	3227	3227	6454
2	Rimbushje dhe Kolaudim fikëse zjarri (AFFF 6 liter shkume)	copë	182	182	364
3	Rimbushje dhe Kolaudim Fikëse zjarri me CO2 2kg	copë	4	4	8
4	Rimbushje dhe Kolaudim Fikëse zjarri me CO2 5kg	copë	74	74	148
5	Rimbushje dhe Kolaudim pajisje Fikëse	copë	14	14	28

	zjarri me pluhur ABC mbi 40% 9 kg				
6	Rimbushje dhe Kolaudim pajisje Fikëse zjarri me pluhur ABC mbi 40% 12 kg	copë	121	121	242
7	Rimbushje dhe Kolaudim pajisje Fikëse zjarri me pluhur ABC mbi 40% 25 kg	copë	1	1	2
8	Rimbushje dhe Kolaudim pajisje Fikëse zjarri me pluhur ABC mbi 40% 30 kg	copë	9	9	18
9	Rimbushje dhe Kolaudim pajisje Fikëse zjarri me pluhur ABC mbi 40% 50kg	copë	18	18	36

Afatet e ekzekutimit:

Shërbimet	Përshkrimi	Shuma	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit
1.	Shërbim për rimbushjen dhe kolaudimin e pajisjeve kundër zjarrit	Sipas tabelës në Shtojcën 7	Vendodhja e objekteve arsimore dhe publike	24 (njetet e kater) muaj nga nënshkrimi i Marreveshjes Kuader

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Objekti i këtij prokurimi është **“Shërbim për rimbushje dhe kolaudim për pajisjet kundër zjarrit”** me qëllim vënien në efikasitet të plotë të fikseve të zjarrit dhe pajisjeve ndihmëse të tyre për efekt gadishmërie në rast rënie zjarri.

Detyrat:

Operatori ekonomik merr përsipër të kryejë shërbimet me cilësi dhe në kohën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarte të tenderit. Operatori ekonomik duhet të komunikojë për çdo problem të hasur gjatë kryerjes së shërbimit me personin ose personat të cilët do të ngarkohen nga autoriteti kontraktor për mbikqyrjen e realizimit të shërbimeve.

Për çdo rast të përdorimit të fikseve të zjarrit operatori ekonomik fitues duhet patjetër që brenda 24 orëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti kontraktor të realizojë rimbushjen dhe kolaudimin e fikseve të përdorura. Në këtë rast do të lidhet minikontratë bazuar në marrëveshjen kuadër.

Autoriteti kontraktor rezervon të drejtën që në çdo rast të kërkojë nga kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës shërbimin e kolaudimit dhe rimbushjes për pajisjet kundra zjarrit dhe në objekte të tjera përveç atyre që janë parashikuar në DST, brenda territorit të Bashkisë Tiranë referuar çmimeve për njësi dhe llojit të pajisjeve të parashikuara në marrëveshjen kuadër.

Për sa i përket zgjidhjeve teknike për mënyrën e kryerjes së shërbimit të rimbushjes dhe kolaudimit të fikseve të zjarrit ajo është në tagrin e operatorit ekonomik kontraktues duke zbatuar normat teknike në fuqi dhe përgjegjësia teknike dhe ligjore është e tij.

Në shërbimin për rimbushjen e dhe kolaudimin e pajisjeve kundër zjarrit të përfshihet edhe ndërrimi i pjesëve të konsumuara ose të dëmtuara në rast konstatimi. Afati i garancisë së kryerjes së shërbimit do të jetë 1 (një) vit nga kryerja e shërbimit për çdo pajisje.

Shpërndarja:

Shpërndarja e kryerjes së shërbimeve do të realizohet sipas përcaktimeve të autoritetit kontraktor në grafikun e shpërndarjes së objekteve në të cilat do kryhet shërbimi i përcaktuar në dokumentet standarte të tenderit.

Vendi i kryerjes së shërbimeve:

Vendodhja e objekteve shkollore dhe parashkollore në të cilat ndodhen fikset e zjarrit për të cilat do të kryhet shërbimi i kërkuar në këtë procedurë prokurimi është e **përcaktuar në Shtojcën bashkangjitur DST.**

Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, **sipas shtojcës 10;**

b. Sigurimin e Ofertës, **sipas Shtojcës 3;**

2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 9001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.

2.1.2 Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë çertifikatat ISO të kërkuara janë të detyrueshme për të gjithë operatorët sipas pjesëmarrjes në kontratën e bashkëpunimit.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2022, 2023, 2024) të çertifikuara nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.2.2 Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2022, 2023, 2024) të jetë jo më e ulët se 40% e vlerës së fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2025 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

Shënim: Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer shërbime të ngjashme në një vlerë jo më të ulët se 20% të fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë; a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të deklaruara në organet tatimore të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e shërbimeve të realizuara ose kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses

të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shprehen qartë datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, b) Për shërbime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklarate (nga Administratori i operatorit ekonomik ofertues), Personin Përgjegjës për kryerjen e shërbimeve në objekte, i cili duhet të figurojë në listëpagesën e subjektit për periudhën Prill 2025 – Maj 2025 dhe në vazhdim, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë pune e vlefshme.
- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Prill 2025 – Maj 2025.

Shënim: Ky kriter (2.3.2) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një dëshmi nga administrata tatimore për punësimin mesatar të jo më pak se 5 (pesë) punonjësve për periudhën Prill 2025 – Maj 2025 dhe në vazhdim, të vërtetuar me dokumentacionin si vijon;

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën Prill 2025 – Maj 2025.
- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Prill 2025 – Maj 2025.

Shënim: Ky kriter (2.3.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e vet për periudhën Prill 2025 – Maj 2025 dhe në vazhdim, të vërtetuar me listëpagesa, kontratë pune (të vlefshme) 1 (një) punonjës i çertifikuar për shërbimin e mirëmbajtjes së pajisjeve kundra zjarrit sipas objektit të prokurimit nga një ent çertifikues i akredituar ose nga një subjekt i licensuar për arsimin profesional ose nga një kompani prodhuese e pajisjeve kundra zjarrit.

Shënim: Ky kriter (2.3.4) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë

autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në pronësi ose me qira të paktën 1 (një) automjet ATP (automjet i transportit të përzier) ose 1 (një) automjet ATV (automjet i transportit të veçantë) për realizimin në kohë të shërbimeve objekt të prokurimit. Për këtë duhet të paraqesë, (Lejen e Qarkullimit, Siguracionin dhe Kolaudimin) të vlefshme, ose në rast se nuk e ka automjetin në pronësi të paraqesë kontratën e qirasë për një afat sa kohëzgjatja e kontratës së parashikuar si dhe dokumentacionin shoqërues për qarkullimin e automjetit (Lejen e Qarkullimit, Siguracionin dhe Kolaudimin) të vlefshme.

Shënim: Ky kriter (2.3.5) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 1 (një) makineri për rimbushjen e fikseve të zjarrit (Pluhur ABC + Shkumë AFFF + CO₂) dhe të paraqesë dokumentacion vërtetues për disponimin e tij (akt zhdoganimi dhe/ose faturë blerje dhe/ose çdo dokumentacion ligjor që e vërteton) dhe duhet të paraqesë katalog/ose fragmente të katalogut të pajisjes ku të specifikohet qartë pajisja dhe proceset e saj të punës dhe foto të pajisjes e cila ndodhet në mjediset e operatorit ekonomik ofertues. Autoritetit kontraktor i lind e drejta që gjatë procesit të vlerësimit të ofertave të verifikojë në vend disponimin e pajisjes së kërkuar në mjediset e operatorit ekonomik ofertues.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor katalogët/fragmente të katalogut ose skedat teknike të publikuara nën autoritetin e prodhuesit për produktet: Pluhur ABC, 40%, Shkumë AFFF 916 (3-6%) dhe Dioksid Karboni (CO₂), që do të përdoren në shërbimet që do të kryhen sipas objektit të prokurimit. Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pajisjet e përzgjedhura, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin. Dokumentacioni i kërkuar për këtë pikë duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo specifikimi teknik të kërkuar në DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim prodhuesi/deklaratë furnizimi nga prodhuesi/autorizim distributori i autorizuar, të vlefshme, për produktet: Pluhur ABC 40%, Shkumë AFFF 916 (3-6%) dhe Dioksid Karboni (CO₂), që do të përdoren në shërbimet që do të kryhen sipas objektit të prokurimit. Në rast se do të paraqitet deklaratë nga Distributori i Autorizuar duhet të paraqitet një akt marrëveshje midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit, të vlefshme. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

SHËNIM: Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (të ndryshuar), ku konkretisht në pikën 6 të nenit 26 parashikohet:.....*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.....*

Përsa më sipër, ofertuesi i kualifikuar, i pari, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin, e parashikuar në pikën 6 të nenit 26, të Rr.P.P., brenda afatit 5 ditor që ka në dispozicion autoriteti kontraktor, për publikimin e njoftimit të fituesit, sipas nenit 97/1, të LPP-së.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 10.

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri	i	NIPT –	Përqindja	e	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to
------	---	--------	-----------	---	------------------------------------

nënkontraktorit të propozuar	i	nënkontraktimit	për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
